

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---



<http://www.revistamapo.com/lexo.php?id=3051>

Tri gra të forta që thonë “Jo”

**Nga: Preç Zogaj**

Historitë, sado tronditëse apo subtile qofshin, as të mahnisin, as të tërheqin nëse nuk shkrihen bukur. Sekretet e suksesit të veprës së Marian Ndiaye qëndron te niveli i lartë i të shkruarit, te gjallëria dhe finesa me të cilën ajo arrin të pasqyrojë e përcjellë te lexuesit lëndën e romanit saj

Një roman i ri në libraritë e Tiranës është ngjitur menjëherë në top listën e librave cilësorë të këtij viti. Titullohet “Tri gra të forta” ( Trois femmes puissantes) përkthyer në shqip nga origjinali frengjisht nga **Amantia Kapo** dhe botuar nga “Toena”. Autorja e romanit është shkrimtarja Marie Ndiaye, një dyzet e pesë vjeçare “e përzier” me babanë senegalez dhe nënën franceze, që ka zgjedhur të banojë së fundi në Berlin me tre fëmijët e saj. Kritikët dhe njohësit e krijimtarisë së Ndiaye mendojnë se “Tri gra të forta” është vepra e saj më e arrirë në pikpamje të bukurisë së të shkruarit dhe trajtimit me thellësi e finesë të subjekteve. Jo rastësisht ky roman ka fituar çmimin “Gunkur” për vitin 2009, çmimi më i rëndësishëm që jep Franca për vepra me autorë francezë. Romani është konceptuar si një triptik. Janë tri histori pa lidhje me njëra tjetrën, që mund të lexohen si novela me vete. Por ato i lidh filli i brendshëm i problematikës që shtron autorja, tendenca e saj për të qëmtuar nga tabloja e jetës së përditshme ngjarje dhe episode që lartësojnë figurën e gruas, stoicismin dhe dinjitetin e saj, forcën dhe madhështinë e saj, guzin dhe pushtetin e saj në një botë në lëvizje, ku maskilizmi dhe feminizmi vihen herepashere ballëpërballë me misteret përkatëse, me pajtueshmëritë dhe papajtueshmëritë përkatëse, duke prodhuar në këtë përballje ngjarje dhe drama që në thelbin e tyre hapin rrugën e një kuptimi dhe mirëkuptimi më të thellë e me të plotë mes sekseve të ndryshme, një mirëkuptim i themeluar mbi dallimin dhe respektin e ndërsjellë, sikurse edhe mbi ngjashmërinë dhe njësimin si qenie të zotit.

Në këtë sfidë, që ka nisur dhe vijon prej shekujsh si një përpjekje emancipuese, qytetërimi ka shkuar më larg aty ku vetë gruaja ka mundur të luftojë më shumë e të imponohet në skenën e historisë dhe familjes si vlerë e epërme, me të cilën burri barazohet jo duke pritur, por duke u ngritur edhe ai në lartësitë e njohjes, respektit dhe adhurimit të saj. Shkrimtarja Marie Ndiane ka pasqyruar në romanin e saj historitë e tri grave, të cilat jeta i vë para një dilemë të madhe: ose të thonë “jo”, domethënë të ngrenë krye; ose të përshtaten, të ulin kokën apo “ të bëjnë gruan”, siç do të thuhej në të folurën dogmatike për “seksin e dobët”. Merret me mend se gratë e forta të romanit tonë e zgjidhin si heroina dilemën ku i vendosin rrethanat. Jo në kuptimin libreshk, por në kuptimin modern të heroizmit, si një kundërvënia kulturore dhe shpirtërore ndaj tabuve, shtypjes, poshtëritimit, nënçmimit e tjerë.

Këto tri gra janë Norah në pjesën e parë të triptikut, Fanta në pjesën e dytë dhe Khady në pjesën e

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---

tretë. Tri femra krejt të ndryshme, që vinë nga civilizime të ndryshme, por që kanë përbashkët sprovën e përballjes me paragjykimin apo poshtërimin.

Norah është një avokate e rrahur nga provinca, që ka arritur të ndërtojë çerdhen e jetës dhe karrierës në Paris. Ajo jeton midis dyshimeve për natyrën e njerëzore të transformuar nga nevojat dhe detyrimeve për vëmendje dhe përkujdesje ndaj babajt të saj të çuditshëm, një ish biznesmen që ka patur dikur kultin e pastërtisë dhe elegancës, por që ka rënë në mjerim dhe dëshpërim për shkak të një ndërlikimi të papritur të jetës së tij. Ky burrë i fuqishëm është martuar disa herë, por martesat e fundit në moshë të shtyrë është shdërruar në një dramë për të dhe për djalin e tij. Gruaja e re ka qenë gjatë gjithë kohës e dashuruar me djalin. Edhe dy fëmijet i ka me të. Një ditë prej ditësh kjo grua e gjorë do të ketë fatin të mbytet me litar nga i shoqi. Këtu zë fill intriga e novelës. Vrasësi bind të birin, domethënë të dashurin dhe bashkëshortin de fakto të gruas, të marrë përsipër vrasjen dhe të pranojë burgosjen. I shtërnguar nga pesha e “pabesisë” ndaj të jatit, i biri nënshtrohet. Ndërkaq, babaj-vrasës, duke dashur ta mbyllë brënda gjakut të vet historinë e krimit, i kërkon Norah të bëhet avokatja e vëllajt të burgosur si bedel. Norah shkon në burg dhe takon vëllanë e tjetërsuar nga goditjet e shumfishta të fatit. Në përballjen me të vërtetën e krimit, ajo merr vendimin të mos jetë vajza e vrasësit që është thirrur prej këtij të fundit për t’i venë kapak tragjedisë, por të jetë një juriste, një grua, një motër, një qytetare. Ajo do të jetë avokatja e së vërtetës, pavarësisht se kjo do të kushtojë babajt të saj. Situatat, mëdyshjet dhe refleksionet që përcjellin Norah drejt vendimit që do të marrë janë dhenë me vërtetësi dhe forcë të madhe artistike nga shkrimtarja.

Në bindjen time pjesa më e bukur e triptikut është e dyta. Gjejmë aty një kryevepër të paraqitjes së subtilitetit të marrëdhënieve burrë-grua, të goditura nga të gjitha anët nga një kompleksitet ndjenjash dhe të varura jo pak nga statusi ekonomik apo shoqëror i partnerëve. Personazhi kryesor i kësaj pjese, Fanta, është një grua e bukur, mësuese letersie, që nuk “del” asnjëherë në skenë. E gjithë novela rrotullohet rreth saj në formën e perjetimeve, dyshimeve, xhelozisë, dashurisë dhe paragjykimeve që tjerr rreth saj i shoqi, Rudi, një burrë i ndersëm, por i pasukseshëm. Ngjarjet janë me shumë mendore se sa “materiale”. Fillojnë në agim, kur Rudi del nga shtëpia dhe përfundojnë në mbremje, kur ai merr rrugën e kthimit në shtëpi, mu sikur po kthehet nga një betejë e gjatë ku ka marrë përgjigje për një mori dyshimesh e divergjencash me gruan e tij krenare. Fanta nuk i rrefehet, madje nuk i shpjegohet për asgjë të shoqit. Ai është xheloz për të. Dyshon se pronari e firmës ku punon dhe një skulptor matrapaz në qytet kanë patur marrëdhënie me të. Ka përshtypjen se lidhja me Fantën nuk ka të ardhme, kompeksitet e tij ndaj saj janë shumë të forta, fati i keq sikur e flak akoma më larg gruas që dashuron, që është ndërkaq tortura e tij. Fanta, e dhe pse nuk vjen asnjëherë drejtpërsëdrejti në faqet e novelës, e edukon me fuqinë e pushtetit dhe inteligjencës së saj këtë burrë. Novela është një lloj himni për forcën ndikuese të gruas. Por sekretet qëndron gjithnjë në faktin se si çlirohet kjo forcë. Fanta është gruaja e thjeshtë dhe moderne, që jeton me forcën e saj të brëndshme, por nuk don të duket sikur është e tillë. Si në një varg të poetit italian Cesare Pavese, që shkruante për gruan “në heshtjen tende të mbyllur është forca jote”. Rudi i nivelës sone këkron ta tërheqë Fantën në shpjegime, në justifikime, por ajo “nuk lëviz nga vendi”, mu sikur ta dijë se shpjegimet janë gjithësesi një lloj nënshtimi, prej nga vështrirë se del ndonjë gjë e mirë. Dashuria duhet t’i pikasë dhe jo t’i shpjegojë sekretet e shpirtit të tjetrit apo tjetrës. Novela në fjalë sjell një pamje të menyrës së të menduarit dhe stilit të të jetuarit në Francën periferike. Ne dallojmë dhe ndjejmë në faqet që ka shkruar Marie Ndiaye ngjyrat dhe tonet e jetës së sotme në këtë Francë deri dje të pabanuar.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---

Pjesa e tretë e tritikut është një epopë e vërtetë për këmbënguljen në kërkim të lirisë dhe njëkohësisht një elegji për pamundësinë në një rrethanë të caktuar. Kjo është epikeja e Khady, që refuzon fatin e skllaves në atdheun e saj afrikan dhe mëton të udhëtojë me këmbët e saj drejt “botës së lirë”. Por sakrificat e e çojnë deri në kufi ku do të mbesë në rrjetën metaforike të fatit. Në njëfarë menyre ajo është viktimë e pëprjekjeve të saj për dinjitet. Ajo nuk është një shembull, por është një histori që vlen të tregohet Khady na kujton vajzat dhe gratë shqiptare që paten marrë në sy rreziqe vdekjeprurëse në kalvarin e tyre drejt perëndimit.

Por të tria gratë e këtij romani kanë diçka nga jeta e përditdhme e shumicës së femrave në planetin tonë.

Historitë, sado tronditëse apo subtile qofshin, as të mahnisin, as të tërheqin nëse nuk shkrihen bukur. Sekretet e suksesit të veprës së Marian Ndiaye qëndron te niveli i lartë i të shkruarit, te gjallëria dhe finesa me të cilën ajo arrin të pasqyrojë e përcjellë te lexuesit lëndën e romanit të saj.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---

<http://www.gazeta-shqip.com/kulture/0b160fe5e419c5220e11607e9782e10b.html>

## Librat e rinj

2011-06-26

*Marie Ndiaye*

*"Tri gra të forta"*

*Përktheu: Amantia Kapo*

*Botoi: "Toena"*

Tri gra, tri histori që nuk kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën, por në qendër të secilës është fati i tri grave. Secila prej tyre gjendet përballë vështirësive dhe i duhet forcë për t'i përballuar ato. Ndjeshmëria artistike me të cilën autorja i përshkruan fatet e tyre, bën që çdo femër të gjejë një copë të së përditshmes në to. Autorja rreket të gjejë se çfarë fshihet pas familjeve në dukje të lumtura: të vërtetat e fshehura. Marie Ndiaye ka lindur më 1967 nga një baba senegalez dhe një nënë franceze. Autorja e ka kaluar jetën e saj në periferitë e Francës ku ka filluar të shkruajë që në moshën 12-vjeçare. Shkruan një roman thuajse në çdo dy vjet, por është edhe autore dramash. "Tri gra të forta" është fitues i çmimit "Concourt" për vitin 2009.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---



Trilogjia "Tri gra të forta", roman i fateve

Libri "Tri gra të forta" flet për tri gra afrikane, secila e ndarë (sikurse autorja) mes Afrikës dhe Francës: Norah kthehet te shtëpia e babait të saj në Afrikë; Fanta e cila jep mësim në Dakar, por detyrohet të ndjekë të shoqin drejt një jete të vështirë në Francë dhe së fundi Khady Demba vejusha afrikane pa asnjë qindarkë në xhep, përpiqet të ndërmarrë një udhëtim për të shkuar në Francë të kushërira e saj.

Ky është një roman i konceptuar si një trilogji. Tri ngjarje, tri histori që nuk kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën, por në qendër të secilës është fati tri grave. Secila prej tyre gjendet përballë vështirësive, e i duhet forcë për t'i përballuar ato. Ndjeshmëria artistike me të cilat autorja i përshkuan fatet e tyre, bën që çdo femër të gjejë një copë të së përditshmes në to. Autorja, rreket të zbulojë se çfarë ka pas dyerve të familjeve: të vërtetat e fshehura. Ato të vërteta të frikshme të cilat barten në shpirt e dihen nga të gjithë, por nuk thuhën.

Karakteret të spikatura, ndërthuren me ngjarje dinamike që i japin jetë, ngjarjeve e personazheve. Kjo është një vepër që flet për rrënimin moral por edhe për humanizëm; për vuajtjen dhe forcën. Kjo nuk është historia e tri femrave afrikane, kjo është historia e të gjitha femrave, në çdo cep të rruzullit tokësor që brenda tyre mbartin një forcë të jashtëzakonshme për t'u ngritur e për të ecur më kokën lart. Autorja është shprehur se kjo vepër është një kompozim muzikor, ku të tri pjesët lidhen nga një temë e vetme. E përkthyer njëkohësisht në gjermanisht, italisht, dhe spanjisht "Tri gra të forta" përçon frymën e pozitivizmit dhe të shpresës.

NDiaye, tashmë 42-vjeçare ka lindur në Francë nga një baba senegalez dhe nga një nënë franceze. Ajo filloi të shkruajë qysh kur ishte 12 vjeçe dhe në moshën 18-vjeçare botoi romanin e parë "Për një të ardhme të pasur" (Quant au riche avenir). Në 2001 ajo fitoi çmimin "Femina" për romanin "Rosie Carpe". Bagazhi i saj letrar sot numëron 10 romane, 4 drama, 3 romane për fëmijë dhe 1 ese.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---



<http://www.zeri.info/artikulli/4/22/26979/roman-per-grate/>

## Roman për gratë

Ragip Sylaj | 01-06-2011 12:29 CET

Romani “Tri gra të forta” i autores Marie NDiaye vjen në gjuhën shqipe në përkthim të Amantia Kapos dhe në botim të ShB “Toena”. Fitues i çmimit më prestigjioz në Francë “Goncourt” në 2009, e bën autoren Marie NDiaye të parën femër me ngjyrë që merr këtë çmim, i cili ka një traditë 106-vjeçare.

Libri “Tri gra të forta” (304 faqe), sipas botuesit flet për tri gra afrikane, secila e ndarë (sikurse autorja) ndërmjet Afrikës dhe Francës: Norah kthehet te shtëpia e babait të saj në Afrikë; Fanta e cila jep mësim në Dakar, por detyrohet të ndjekë të shoqin drejt një jete të vështirë në Francë dhe së fundi Khady Demba vejusha afrikane pa asnjë qindarkë në xhep, përpiqet të ndër marrë një udhëtim për të shkuar në Francë të kushërira e saj.

Ndjeshmëria artistike me të cilat autorja i përshkuan fatet e tyre, bën që çdo femër të gjejë një copë të së përditshmes në to. Autorja, rreket të zbulojë se çfarë ka pas dyerve të familjeve: të vërtetat e fshehura. Ato të vërteta të frikshme të cilat barten në shpirt e dihen nga të gjithë, por nuk thuhet. Karaktere të spikatura, ndërthuren me ngjarje dinamike që i japin jetë, ngjarjeve e personazheve.

Kjo është një vepër që flet për rrënimin moral por edhe për humanizëm; për vuajtjen dhe forcën. Kjo nuk është historia e tri femrave afrikane, kjo është historia e të gjitha femrave, në çdo cep të rruzullit tokësor që brenda tyre mbartin një forcë të jashtëzakonshme për t’u ngritur e për të ecur më kokën lart.

Autorja është shprehur se kjo vepër është një kompozim muzikor, ku të tri pjesët lidhen nga një temë e vetme. E përkthyer njëkohësisht në gjermanisht, italisht, dhe spanjisht “Tri gra të forta” përçon frymën e pozitivizmit dhe të shpresës. NDiaye, tashmë 42-vjeçare ka lindur në Francë nga një baba senegalez dhe nga një nënë franceze. Ajo filloi të shkruajë qysh kur ishte 12 vjeçe dhe në moshën 18-vjeçare botoi romanin e parë “Për një të ardhme të pasur”.

Në 2001 ajo fitoi çmimin “Femina” për romanin “Rosie Carpe”. Veprimtaria e saj letrare tash për tash numëron dhjetë romane, katër drama, tri romane për fëmijë dhe një ese. Përveç temave sociale (diferencave racore dhe gjinore) historitë e saj janë shpesh surreale.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---



<http://www.shekulli.com.al/shekulli/2011/07/04/libra-te-rinj-2/>

## Tri gra të forta

Marie NDiaye

Botues: Toena,

**Përktheu: Amantia Kapo**

304 faqe

Tri rrëfime, tri gra që thonë jo. Quhen Norah, Fanta, Khady Demba, vijnë dhe kthehen në Afrikë. Secila lufton për të ruajtur dinjitetin përballë poshtëtimeve që jeta iu pret rrugën në mënyrë të vazhdueshme. Me këtë roman Marie NDiaye u bë e para autore me ngjyrë që fitoi çmimin më prestigjioz letrar në Francë “Goncourt”, në vitin 2009.

**Klan**

E perjavshme Informativ

<http://www.revistaklan.com/material.php?id=1658>

“Tri gra te forta”, liber nga Marie NDiaye. Ky liber flet per tri gra afrikane, secila e ndare mes Afrikes dhe Frances. Romani eshte konceptuar si trilogji. Tri ngjarje, tri histori qe nuk kane lidhje logjike me njera-tjetren, por ne qender te seciles eshte fati i tri grave. Secila prej tyre gjendet perballe veshtiresive e i duhet force per ti perballuar ato. Ndjeshmeria artistike me te cilen autorja i pershkruan fatet e tyre, ben qe cdo femer te gjeje nje cope te se perditshmes ne to. Vepra flet per rrenimin moral.

“Tri gra te forta”

Marie NDiaye

Botues: “Toena”, **Përktheu: Amantia Kapo**, 304 faqe

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---

## Agjencia e Lajmeve ALBPRESS

### Tri gra të forta

Marie NDiaye. Libri flet për tri gra afrikane, secila e ndarë (sikurse autorja) mes Afrikës dhe Francës. Ky është një roman i konceptuar si një triologji. Tri ngjarje, tri histori që nuk kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën, por në qendër të secilës është fati i tri grave. Secila prej tyre gjendet përballë vështirësive e i duhet forcë për t'i përballuar ato. Ndjeshmëria artistike me të cilat autorja i përshkuan fatet e tyre, bën që çdo femër të gjejë një copë të së përditshmes në to.



<http://www.shkodraonline.com/comment.php?comment.news.4708>

· “Tri gra të forta” romani i autores Marie NDiaye vjen në gjuhën shqipe në përkthim të **Amantia Kapos**. Fitues i çmimit më prestigjioz në Francë “Goncourt” në 2009, e bën autoren Marie NDiaye të parën femër me ngjyrë që merr këtë çmim, i cili ka një traditë 106-vjeçare. Libri “Tri gra të forta” flet për tre gra afrikane, secila e ndarë (sikurse autorja) ndërmjet Afrikës dhe Francës. Ndjeshmëria artistike me të cilat autorja i përshkuan fatet e tyre, bën që çdo femër të gjejë një copë të së përditshmes në to. Autorja, rreket të zbulojë se çfarë ka pas dyerve të familjeve: të vërtetat e fshehura. Ato të vërteta të frikshme të cilat barten në shpirt e dihen nga të gjithë, por nuk thuhën. Karaktere të spikatura, ndërthuren me ngjarje dinamike që i japin jetë, ngjarjeve e personazheve. Kjo është një vepër që flet për rrënimin moral por edhe për humanizëm; për vuajtjen dhe forcën. Kjo nuk është historia e tri femrave afrikane, kjo është historia e të gjitha femrave, në çdo cep të rruzullit tokësor që brenda tyre mbartin një forcë të jashtëzakonshme për t’u ngritur e për të ecur më kokën lart.



# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---



## Vitrina javore e librit

[http://www.pronaindi.com/tv1channel/index.php?option=com\\_content&view=category&layout=blog&id=18&Itemid=83](http://www.pronaindi.com/tv1channel/index.php?option=com_content&view=category&layout=blog&id=18&Itemid=83)

Sunday, 05 June 2011 12:10 Lajme

· “Tri gra të forta” romani i autores Marie NDiaye vjen në gjuhën shqipe në përkthim të Amantia Kapos. Fitues i çmimit më prestigjioz në Francë “Goncourt” në 2009, e bën autoren Marie NDiaye të parën femër me ngjyrë që merr këtë çmim, i cili ka një traditë 106-vjeçare. Libri “Tri gra të forta” flet për tre gra afrikane, secila e ndarë (sikurse autorja) ndërmjet Afrikës dhe Francës. Ndjeshmëria artistike me të cilat autorja i përshkuan fatet e tyre, bën që çdo femër të gjejë një copë të së përditshmes në to. Autorja, rreket të zbulojë se çfarë ka pas dyerve të familjeve: të vërtetat e fshehura. Ato të vërteta të frikshme të cilat barten në shpirt e dihen nga të gjithë, por nuk thuhën. Karaktere të spikatura, ndërthuren me ngjarje dinamike që i japin jetë, ngjarjeve e personazheve. Kjo është një vepër që flet për rrënimin moral por edhe për humanizëm; për vuajtjen dhe forcën. Kjo nuk është historia e tri femrave afrikane, kjo është historia e të gjitha femrave, në çdo cep të rruzullit tokësor që brenda tyre mbartin një forcë të jashtëzakonshme për t’u ngritur e për të ecur më kokën lart.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---



<http://www.gazeta-agon.com/mat.php?idm=19472&l=a>

“Tri gra të forta”, NDiaye në shqip

Janë tri gra afrikane, secila e ndarë mes Afrikës dhe Francës: Norah kthehet te shtëpia e babait të saj në Afrikë; Fanta e cila jep mësim në Dakar, por detyrohet të ndjekë të shoqin drejt një jete të vështirë në Francë dhe së fundi Khady Demba, vejusha afrikane pa asnjë qindarkë në xhep, përpiket të ndërmarrë një udhëtim për të shkuar në Francë të kushërira e saj.

Pak a shumë kjo është linja mbi të cilën ndërtohet subjekti i romanit “Tri gra të forta” i Marie NDiaye, i cili vjen i botuar në shqip. Libri është konceptuar si një trilogji, tri ngjarje, tri histori që nuk kanë lidhje logjike me njëra-tjetrën, por në qendër të secilës është fati i tri grave. Secila prej tyre gjendet përballë vështirësive e i duhet forcë për t’i përballuar ato. Autorja rreket të zbulojë se çfarë ka pas dyerve të familjeve: të vërtetat e fshehura. Ato të vërteta të frikshme, të cilat barten në shpirt e dihen nga të gjithë, por nuk thuhën. Karaktere që ndërthuren me ngjarje dinamike, që i japin jetë ngjarjeve e personazheve. Kjo është një vepër që flet për rrënimin moral por edhe për humanizëm; për vuajtjen dhe forcën. Kjo nuk është historia e tri femrave afrikane, kjo është historia e të gjitha femrave, në çdo cep të rruzullit tokësor, që brenda tyre mbartin një forcë të jashtëzakonshme për t’u ngritur e për të ecur më kokën lart.

Autorja është shprehur se kjo vepër është një kompozim muzikor, ku të tri pjesët lidhen nga një temë e vetme. E përkthyer njëkohësisht në gjermanisht, italisht, dhe spanjisht “Tri gra të forta” përçon frymën e pozitivizmit dhe të shpresës. “Tri gra të forta” (Trois femmes puissantes) vjen si përkthim i **Amantia Kapos**. Fitues i çmimit më prestigjioz në Francë “Goncourt” në 2009, e bën autoren Marie NDiaye të parën femër me ngjyrë që merr këtë çmim, i cili ka një traditë 106-vjeçare.

Dy fjalë për autoren

NDiaye, tashmë 42-vjeçare, ka lindur në Francë nga një baba senegalez dhe nga një nënë franceze. Ajo filloi të shkruajë qysh kur ishte 12 vjeçe dhe në moshën 18-vjeçare botoi romanin e parë “Për një të ardhme të pasur” (Quant au riche avenir).

Në 2001 ajo fitoi çmimin “Femina” për romanin “Rosie Carpe”. Bagazhi i saj letrar sot numëron 10 romane, 4 drama, 3 romane për fëmijë dhe 1 ese. Përveç temave sociale (diferencave racore dhe gjinore) historitë e saj janë shpesh surreale.

# Revue de presse : Trois femmes puissantes

---

## Vizion Plus

[http://www.vizionplus.tv/index.php?option=com\\_content&view=article&id=579:pamuk-rivjen-ne-shqip-me-muzeun-e-pafajesise-&catid=43:kulture&Itemid=209](http://www.vizionplus.tv/index.php?option=com_content&view=article&id=579:pamuk-rivjen-ne-shqip-me-muzeun-e-pafajesise-&catid=43:kulture&Itemid=209)

E diel, 05 Qershor 2011 15:52

“... “Tri gra te forta”, është romani i francezes Marie Ndiaye, i ardhur mes te rinjve. Botimi është fitues i çmimit më prestigjioz në Francë “Goncourt” në 2009 duke e bërë autoren NDiaye të parën femër me ngjyrë që merr këtë çmim, i cili ka një traditë 106-vjeçare.